

Data 19.05.2023

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Mirëmbajtje Tuneli i Krrabës (2023-2027)”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime
për menaxhim tunelesh 63712320-2**

VLERA E FONDIT LIMIT: 379,248,000 (treqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e dyqind e
dyzet e tetë mijë) **Lekë, pa TVSH.**

Në Euro: 3,374,693.01 (tre milion e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e
nëntëdhjetë e tre presje zero një) **pa TVSH.**

Në bazë të *Nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,* autoriteti/enti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për vitin 2022 (sipas shkresës së DPBF nr. 3911/2 prot, datë 16.05.2023. Bazuar në *Nenin 42, pika 1 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve”.* Në rastin konkret, teknikisht është e pamundur të ndahet në lote. Ndarja në lote e objektit do të komplikonte rakordimin e punimeve civile dhe proceseve të punës, e për pasojë do sillte risqe të mëdha për përfundimin e veprës në kohë dhe në cilësi.

Në zbatim të *pikës 2 të Nenit 56 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pikës 3 të Nenit 24 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,* Autoriteti Kontraktor do të publikojë njoftimin e kontratës në gjuhën Angleze në gazetën **“TED”** me shpërndarje në Europë.

Në zbatim të pikës 2 Neni 12 i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka konvertuar vlerën limit të kontratës në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë data **18.05.2023, ora 12:27:07**

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021, 2022** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenin 43 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është: “Procedurë e Hapur - Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar - Marrëveshje Kuadër - prokurim publik me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenit 43, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020, 2021, 2022** (*Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009*), **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenin 43, pika 4, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale.

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë, kopje të kontratës së nënshkruar nga entiteti publik, Vërtetime të lëshuara nga një entitet publik, (ose formulari vlerësimi në rastet kur lëshohet një i tillë) për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.1/1 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posaçme te deklaruar ne fazen e tenderimit;

2.3.1/2 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e shërbimeve / punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër.

Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e shërbimeve / punimeve objekt kontrate duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-11-A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja të TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë

2	NS-5-A	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut
3	NS-6-A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese
4	NS-12-A	Impiante teknologjikë, termikë dhe të kondicionimit
5	NS-13-A	Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni
6	NS-14-A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Duke qënë se kemi të bëjmë me kontratë shërbimi, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë kategori licencash, sepse në preventivin e parashikuar në kapitullin ”Lump sum”, i cili parashikon rifreskimin e sinjalistikës rrugore ndriçuese dhe jondricuese, impiante të teknologjisë termike dhe të kondicionimit, impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni, impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV. Secila nga këto zëra nuk e kalojnë vlerën 20 milion lekë, konform VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve / punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtoresh minimalisht **40 (dyzet) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën **Nëntor 2022 - Prill 2023**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9. **Ndërsa operatori ekonomik fitues, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Nëntor 2022 - Prill 2023**.

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Nëntor 2022 - Prill 2023**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Duke qënë se objekti është shërbime në vazhdimësi për një periudhë 48 mujore, numri i përcaktuar i fuqisë punëtore është përlllogaritur në shërbimet e kërkuara të përcaktuara në Termat e Referencës të objektit që prokurohet “**Mirëmbajtje Tuneli i Krrabës (2023-2027)**”

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve / punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastrukturë e Transportit)
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Elektronik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik / Elektrik / Elektronik

***Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

*** Stafit teknik i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Gjithashtu, argumentojmë se drejtuesit teknik në licencën e shoqërisë duhet të jenë:

-Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastrukturë e transportit), pasi është i domosdoshëm për administrimin e incidenteve rrugore, si dhe inspektimin e sigurisë rrugore.

-Inxhinieri Mekanik / Elektrik / Elektronik do të jetë përgjegjës për të siguruar standartin e duhur të cilësisë së mirëmbajtjes së pajisjeve dhe të sistemeve të tunelit.

- Inxhinieri Mekanik duhet për zhvillimin e shfrytëzimin e operacioneve në tunele rrugore dhe procedurave të mirëmbajtjes në to.

-Inxhinier Elektrik duhet pasi do jetë përgjegjës për kontrollin dhe verifikimin e pajisjeve për ndricimin ventilimin, qendrën e kontrollit, etj.

-Inxhinier Elektronik duhet pasi do jetë përgjegjës për kontrollin dhe verifikimin e pajisjeve për ventilimin, qendrën e kontrollit, sistemin e monitorimit etj.

2.3.5 Operatori ekonomik, për realizimin e shërbimeve / punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

2 (dy) *Inxhinier Mekanik*

2 (dy) *Inxhinier Elektrik*

2 (dy) *Inxhinier Elektronik*

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbleds të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 9. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese".*

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

*** Staf i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Staf mbështetës do të punojë me turne, të cilët do të drejtohen nga Menaxheri primar

i tunelit (*Inxhinier Ndërtimi, profili Infrastrukturë e transportit*) për të plotësuar sa më mirë detyrat e Menaxherit primar.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”**, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e *Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”*.
- 1 (një) **ekspert zjarrfikës** me certifikatën përkatëse lëshuar nga Drejtoria e MZSH-së / licencë për mbrojtje nga zjarri të lëshuar nga QKL, **Kodi I.2.A.**

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Stafi i kërkuar në pikën 2.3.6 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe Ligjit nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për

sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës

Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatësë lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentet përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Kërkesa për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri mbështetet sipas Ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin"

2.3.7 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuësin Teknik Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastrukturë e transportit)** në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 9.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: **Diplomë, librezë pune dhe kontratë pune.**

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Drejtuësi teknik i shërbimeve duhet të jetë në licencën e shoqërisë dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt. Drejtuësi Teknik është i nevojshëm lidhur me shërbimin që kërkohet, afatin pr kryerjen e realizimit të shërbimeve. Për më tepër, operatorët duhet të kenë staf të specializuar për natyrën e shërbimeve që prokurohen. Kjo tregon besueshmërinë për autoritetin për kapacitetet e O.E. që kërkojnë të marrin pjesë.

2.3.8 .3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Pronësia</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Autovinç me kosh</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
2	<i>Karrotrec</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
3	<i>Automjet 4x4</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
4	<i>Automjet (Pick up)</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 8. *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.* Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; lejen e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësi vendore dhe fotot përkatëse.

Ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, jemi bazuar në natyrën e shërbimeve që do të kryhen të përcaktuara në Termat e Referencës të objektit që prokurohet “Mirëmbajtje Tuneli i Krrabës (2023-2027)”

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 *Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:*

- ISO 9001:2015 *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë*
- ISO 27001:2022 *Për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit*
- ISO 45001: 2018 *Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*
- ISO 39001:2012 *Sistem i menaxhimit të sigurisë rrugore dhe trafikut*

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:*

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se shërbimet, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.